

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: Seticommerc SH.P.K.; HARST Group SH.P.K., Shiroke - Suharek, 23000, SHIROKË Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	08.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **07.08.2023**, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Seticommerc SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik: Seticommerc SH.P.K.; HARST Group SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **02.08.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e mëtejshëm për këtë aktivitetin të prokurimit
- III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Grup i Operatorëve Ekonomik: Seticommerc SH.P.K.; HARST Group SH.P.K. me adresë në **Suharekë**, me datë: **07.08.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE - LOT I – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-5386-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-027-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **02.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor nuk qëndron dhe është i pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku nuk e keni plotësuar këto kriter sipas Njoftimit për Kontrate/Dosjes se tenderit:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mbështetje nga Banka ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku: 100,000.00 €;

Dëshmia 2: Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, dokumentin e prezantuar nga Banka Ekonomike Sh.A. ne baze te Kërkesë Nr. 2 të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, ku dokumenti ne fjale është i pa pranueshëm për ne si AK: Komuna e Rahovecit, pasi ne Letër Përkrahje nga Banka, ceket: *Banka Ekonomike sh.a. do të shqyrtojmë të mbështesim financiarisht në raste se KOMPANIA e fiton tenderin nga KK Rahovec*, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së

Dokumentin ne fjale nuk mund te kërkohet ne baze te Nenit 72, paragrafi 3. ku thotë:

Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive

Letër Mbështetëse nga Banka, nuk krijon asnjë siguri që Operatori Ekonomik do të ketë qasje për kredi, (mbështetje nga banka) për mjetet financiare te kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, pasi qe Banka nuk pranon asnjë përgjegjësi financiare ne baze te këtij dokumenti, andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës se Prokurimit
Komuna e Rahovecit